

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Implementim i shërbimit të fiskalizimit dhe mirembajtje vjetore”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Shërbimet e lidhura me softwaret - 72260000-5.

VLERA E FONDIT LIMIT: 5 166 667 (pesë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë **pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sha, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë;

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin e ofertës sipas shtojcës 1*
- b. Listën e çmimeve të shërbimeve sipas shtojcës 2*
- c. Formularin Përmbledhës të Vetë-deklarimit, sipas shtojcës 9*
- d. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit

Operatori duhet të ketë të përfshirë në objektin e veprimtarisë në Ekstraktin e QKB edhe objektin e prokurimit të kësaj kontrate.

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriterë duhet të plotësohen me dorëzimin e vetë-deklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Ligjin 162/2020 neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e

nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare nga data e zhvillimit të tenderit ku vlera e xhiros minimale vjetore për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2. Pasqyrat financiare për 3 (tre) vitet e fundit financiare nga data e zhvillimit të tenderit të konfirmuara nga administrata tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05. 03. 2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në bilancet e kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19. 05. 2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në mbështetje të Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 77, “Kërkesat për kualifikim”, pika 1: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”, dhe në mbështetje të VKM – së nr. 285, datë 19. 05. 2023 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43 pika 1: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.”

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Furnizime të mëparshme të ngjashme me një vlerë jo më të ulët se 20% të fondit limit të

objektit të prokurimit, të realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vërtetuar me dokumentacionin si më poshtë:

- për përvojën e mëparshme, realizuar në sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen me të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur OE, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në Ligjin 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe në VKM – në nr. 285 datë 19. 05. 2023, neni 55 “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, pika 4/b “Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”. Për pikën 2.3.1, në rastin e bashkimit të OE, do të respektohet VKM nr. 285 datë 19. 05. 2021, neni 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”.

Me anë të këtyre kriterëve kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë kapacitetin e nevojshëm për zbatimin me sukses të kësaj kontrate, dhe garantojnë AK për kapacitetet e tyre sipas përcaktimeve në Ligjin 162/2020 të LLP, dhe të VKM nr. 285, dt. 19. 05. 2021.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë :

- a) ISO 9001 (për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë)
- b) ISO 27001 (për Sigurinë e Informacionit)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është mbështetur në Ligjin 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 36 “Specifikimet teknike”, pika 3: “Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.”, si dhe në mbështetje të VKM – së nr. 285, datë 19. 05. 2023 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 44 “Kërkesat e cilësisë”, pika 1: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”.

ISO 9001 për sistemin e menaxhimit të cilësisë (ose ekuivalent dhe i vlefshëm):

ISO 9001 (ose ekuivalente) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një game të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga OE, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative, planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korigjuese dhe për të nxitur përmirësimin.

Kërkesa për certifikimin me standartin ISO 9001 ose ekuivalente të saj, është një nga dëshmitë për garantimin e realizimit me sukses të kontratës.

ISO 27001 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit (ose ekuivalent dhe i vlefshëm):

ISO 27001 lidhet me garancinë që kërkon AK nga OE, në lidhje me:

- *mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security Management System) brenda vetë organizatës së OE.*
- *aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë.*
- *aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive.*
- *aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në mjediset sensitive.*

Referuar sa me sipër, ky standard i kërkuar lidhet ngushtësisht dhe drejtpërdrejtë me objektin e kësaj kontrate.

Me anë të kësaj kërkesë, AK kërkon të jetë i garantuar që OE zhvillojnë veprimtarinë e tyre konform rregullave, ligjeve dhe të standarteve në fuqi.

“2.3.3 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 4 (kater) punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj.). Plotësimi i këtij kriteri duhet të vërtetohet me paraqitjen e formularëve E-SIG për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke iu referuar datës së hapjes së ofertave dhe diplomave të shkollimit të lartë universitar për secilin prej punonjësve. Këta punonjës duhet të jenë të certifikuar si vijon dhe një punonjës mund të ketë me shumë se një certifikim:

- a. Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në zbatimin e zgjidhjes së ofruar ose teknologjitë nga të cilat përbëhet zgjidhja.
 - Ky kriter të plotësohet me paraqitjen e certifikatës përkatëse për punonjësit.
- b. Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) punonjës për sigurinë në Cloud.
 - Ky kriter të plotësohet me paraqitjen e certifikatës përkatëse për punonjësit.
- c. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente).
 - Ky kriter të plotësohet me paraqitjen e certifikatës përkatëse për punonjësit.
- d. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në implementimin e web shërbimeve nëpërmjet protokollit SOAP ose REST ose ekuivalent.
 - Ky kriter të plotësohet me paraqitjen e certifikatës përkatëse për punonjësit.

Shënim: Këto kërkesa, OE duhet t’i paraqesin me anë të formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues sipas kërkesave të AK, para shpalljes së njoftimit të fituesit paraprak të kësaj procedure.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në Ligjin 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale,

autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Për përmbushjen me sukses të kontratës, numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, përkundrajt natyrës së punës objekt i këtij prokurimi. Periudha e punësimit jo më pak se tre muaj nga data e publikimit të kësaj kontrate, është tregues për aftësinë profesionale të punonjësve, pasi e kanë kaluar periudhën e provës në marrëdhënie me punëdhënësin. Kjo kërkesë garanton AK për seriozitetin dhe fuqinë punëtore të OE, e domosdoshme për realizimin e kësaj kontrate. Kjo kërkesë është bazuar në Ligjin 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 1: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”

Kriteri për 5 (pesë) punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, informatikë ekonomike, shkenca kompjuterike etj.), është në përputhje me objektin e prokurimit dhe termat e referencës pasi përfshin zbatimin, integrimin, menaxhimin dhe sigurinë e të gjitha informacioneve teknike të sistemit dhe të të dhënave.

Si rrjedhim:

Kriteri për punonjës të certifikuar si ekspert për sigurinë Cloud, është i nevojshëm pasi programi i fiskalizimit bashkë me faturat që do të fiskalizohen, do të jenë të depozituara në Cloud. Për këtë arsye AK duhet të jetë i garantuar që OE në stafin e tij ka punonjës të specializuar në garantimin e ruajtjes së të dhënave, edhe si domosdoshmëri për mbrojtje nga rreziqe të mundshme nga agjentë të jashtëm keqbërës.

Në zbatim të Ligjit Nr. 2/2017, “Për Sigurinë Kibernetike”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 553, datë 15.07.2020, “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”, i ndryshuar, AK është përcaktuar si operator i infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, si rrjedhim sistemi dhe infrastrukturat mbështetëse të ofruara duhet të auditohen dhe të ofrohet përditësim i vazhdueshëm nga ana e sigurisë kibernetike, siç është dhe në specififikimet teknike në paragrafin **Siguria**.

Kriteri për punonjës të certifikuar në përdorimin dhe zbatimin e Web shërbimeve me anë të protokollit SOAP, Rest ose ekuivalente, vjen për të garantuar integrimin mes sistemeve të brendshme me programin e fiskalizimit, integrim ky që përdor protokolle standarde Soap, Rest ose ekuivalente siç është cituar dhe në specifikimet teknike në paragrafin **Integrimi dhe Komunikimi**.

Kriteri për punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve ITIL, vjen si rezultatet i nivelit të shërbimit SLA (shërbimet e mirëmbajtjes). Meqenëse shërbimi do të ofrohet në Cloud, është kritik për Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sha, për të pasur aktivitet ekonomik të pa ndërprerë. Mungesa e shërbimit në rast të mos fiskalizimit, apo mos fiskalizimi në kohën e duhur, ndikon direkt në mungesën e të ardhurave për AK. OE duhet të menaxhojë mbarëvajtjen e ofrimit të shërbimit sipas praktikave ndërkombëtare të mirënjohura të ITIL ose ekuivalente siç është përmendur edhe në specifikimet teknike në paragrafin **Manaxhimi i shërbimit**.

Kriteri për punonjës të certifikuar për menaxhimin e bazës së të dhënave në teknologjinë e zgjidhjes së ofruar, vjen si nevojë për të garantuar mirëmbajtjen, optimizimin, shmangien e ndërhyrjes ose manipulimit të databazës, si dhe për të garantuar performancë maksimale ashtu siç dhe është caktuar në specifikimet teknike në paragrafin **Baza e të dhënave**.

Fushat e mësipërme të ekspertizës si dhe numri i personelit të diplomuar në këtë fushë janë kryer në bazë të komponentëve të objektit të kësaj kontrate, si dhe të masës së angazhimit të specialistëve të nevojshëm për të qenë në mbështetje të AK në periudhën e përfundimit të procesit të fiskalizimit që duhet të mundësohet brenda një afati jo më të gjatë se 2 (dy) ditor. Pra procesi i fiskalizimit të faturave në mënyrë që t'u përgjigjet në kohë kërkesave të klientëve të AK, për shlyerjen e detyrimeve që vijnë si proces i faturimit, duhet të kryhet në një kohë jo më të gjatë se dy ditë në mënyrë që AK t'u përgjigjet me profesionalizëm klientëve të saj.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të jetë licensuar nga A.K.SH.I. dhe D.P.T., për sistemin e fiskalizimit.

Operatori Ekonomik duhet të provojë se disponon Licencë nga A.K.SH.I. dhe D.P.T. për sistemin e fiskalizimit ose i autorizuar nga një prodhues i Licensuar për shitjen e një produkti të Licensuar të fiskalizimit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, germa “a”, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.3.5 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë manual përdorimi në gjuhën shqipe.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në mbështetje të nenit 41, pika 4 c) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në mënyrë që përdoruesit ta kenë sa më të lehtë përdorimin e programit kërkohet që OE ofertues të paraqesë manualin e përdorimit në gjuhën shqipe i detajuar me të gjitha funksionet. Manual i përdorimit bën të mundur kontrollin që ky program fiskalizimi i ka të gjitha komponentët që AK ka parashikuar në specifikimet teknike.

Ky kriter plotësohet me ngarkimin në SPE të manualit të përdorimit në gjuhën shqipe.

Argumentimi i specifikimeve teknike dhe termave të referencës:

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike të këtij shërbimi, janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1 dhe 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor si dhe OE të marrë masat në kohën e duhur që të garantojë kapacitetet për përmbushjen me sukses të kontratës sipas kushteve të përcaktuara.

Te gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s’kualifikim.

NJËSIA E PROKURIMIT